




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Nr.74
Prishtinë, më 19.08.2024

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 26, nenit 27, nenit 29, nenit 35, nenit 36 paragrafi 6 neni 39 si dhe neni 55 paragrafi 2 me nën paragrafin 2.4, i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimin Administrativ nr. 08/2023 për Përcaktimin e Keqpërdorimit të Pozitës Dominuese, bazuar në propozim/ kërkesën e parashtruar nga Endoena Imeri B.I. "BLINI.SI" me NUI: 812010479 adresa: Rruga "Shaban Shala", pn Glllogoc, kundër Bashkësisë Islame dega në Drenas, Komisioni pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit, në mbledhjen e mbajtur me datën 19.08.2024 merr këtë:

KONKLUZION

Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit të situatës në tregun relevant, bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, konstatojmë se nuk ka argumente për fillimin e Procedurës Hetimore ndaj Këshillit të Bashkësisë Islame në Drenas, sipas nenit 36 paragrafi 6 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datën 18.07.2024, me Nr. Prot. 467/24-01/H, ka pranuar propozim/kërkesën nga Endoena Imeri B.I. "BLINIS.SI" me NUI: 812010479 kundër Bashkësisë Islame dega në Drenas, lidhur me ndërprerjen e konkurrencës dominuese të saj.

Pretendimet e paraqitësit të iniciativës:

Ndërmarrja Endoena Imeri B.I. "BLINI.SI" në ushtrimin e veprimtarisë pengohet nga Bashkësia Ismale-me seli në Drenas. Gjithnjë sipas pretendimeve të palës, me datën 09.07.2024 Komuna ka kthyer një përgjigje jo të saktë dhe të pa sqaruar, vetëm se na informon që ka lidhur një kontratë me Bashkësinë Islame në Drenas, duke na mohuar neve që të ushtrojmë veprimtarinë tonë. Kurse Bashkësia Islame në Drenas deri me tani nuk ka kthyer asnjë përgjigje edhe pse të njëjtëve ju kemi drejtuar me të njëjtën kërkesë.

Bashkësia Islame në Drenas në zyrat e saj mban jashtëligjshëm; Arkivola, Tabuta, Piramida, Transportin, Qefinin, Dërrasa dhe bënë hapjen e Varrezave.

Bashkësia Islame në Drenas nuk është e regjistruar fare ne ARBK dhe nuk e ka çertifikatën e regjistrimit ku ka nënshkruar kontratë qe disa vite me radhë me Komunën e Drenasit.

Paraqitësi i iniciativës ka kërkuar që, në zbatimin e dispozitave ligjore të Ligjit Nr.08/L-056. Për Mbrojtjen e Konkurrencës, ti ndërpritet veprimtaria e paligjshme e ushtruar nga Bashkësia

Islame, t'i ndërpritet konkurrenca dominuese e saj , ndaj Operatorit, me pronare Endoena Imeri B.I. "BLINIS SI" dhe ndaj saj të detyrohet pagimi i gjobave, dhe dëmeve tjera të shkaktuara.

Takimi me përfaqësuesit dhe Përshkrimi i Gjendjes Faktike të rastit

Me datën 05.08.2024, grupi punues ka zhvilluar takim në përfaqësuesit e Ndërmarrjes "BLINI SI", në këtë takim deklaruan se:

Bashkësia Islame, është pa status për shkak se nuk është e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) si biznes. Po ashtu, sipas pretendimeve, Bashkësia Islame mbanë jashtëligjshëm Arkivola, Tabuta, Piramida, nëpër çdo Xhami në territorin e Komunës së Drenasit. I njëjti deklaroj se ka kërkuar nga Bashkësia Islame për t'i dhënë mundësi që të bëj transportin e kufomave, rrjedhimisht të mos i detyrojë qytetarët që të gjitha shërbimet të i kryen vetëm Bashkësia Islame. Në Komunën e Drenasit, operojnë në treg dy ndërmarrje private që në aktivitetin e tyre biznesor kanë mundësi ligjorë bartjen e kufomave, të bëjnë shitblerjen e arkivoleve, etj. Ndërsa për pastrimin e kufomave (xhenazës) dhe për rite tjera fetare, të vazhdon të i kryen Bashkësia Islame. Pasi qytetarët bëjnë pagesën e anëtarësisë prej 4 euro në vitë për secilin anëtar të familjes, i njëjti deklarojë se përfaqësuesit e Bashkësisë Islame dega në Drenas, vazhdimisht insistojnë se ata kanë bazë për kryerjen e këtyre aktiviteteve në Kushtetutën e Kosovës dhe në Ligje.

TREGU PËRKATËS APO RELEVANT

Tregu gjeografik - duke iu referuar nenit 4, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e tregut përkatës Nr. 01/2023, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Komunës së Drenasit.

Tregu i produktit – Shërbimet siç janë: (Transporti i Kufomave, Piramidat, Arkivolet, Qefini, Dërrasat, si dhe Hapja e Varrit).

Analiza e Konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës, angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës (Abuzimit me Pozitën Dominuese, Marrëveshjeve të Ndaluar, Praktikave të Bashkërenduara dhe Realizimit të Përqendrimeve të Paligjshme) nga ndërmarrjet ekonomike private apo publike, por edhe nga kufizimet e shkaktuara nga administrata shtetërore dhe entet rregullatorë në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë saj, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.

Parimi themelor i ligjit dhe politikës së konkurrencës është të sigurojë qasje në treg të lirë për çdo ndërmarrje e cila i plotëson kushtet për të konkurruar në atë treg në interes të përdoruesve të shërbimeve dhe të mund të konkurrojë me çmim dhe cilësi.

Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është ruajtja e procesit konkurrues dhe nxitja e konkurrencës efektive në treg. Ruajtja ose nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme, duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat apo ai shtetëror/publik mund t'i bëjnë konkurrencës. Prandaj ligji i konkurrencës ndalon marrëveshjet për fiksimin e çmimit,

abuzimin me pozitë dominuese, si dhe përqendrimet që rrezikojnë të krijojnë një pozitë dominuese në treg.

Autoriteti i Konkurrencës zhvillimin e procedurës e bazon tek neni 35 – Propozimi për Fillimin i Procedurës dhe ex-officio neni 36 - Fillimi i Procedurës, dhe atë në rastet kur kemi të bëjmë me të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ana e ndërmarrjeve që operojnë në tregjet përkatëse.

Autoriteti ka shqyrtuar kërkesën e ndërmarrjes, e cila ka kërkuar t'i ndërpritet marrëveshja e negociuar përmes procedurave të prokurimit, e nënshkruar mes Komunës së Drenasit dhe Bashkësisë Islame në Drenas.

Autoriteti në bazë të dokumentacionit të paraqitur dhe gjendjes faktike të konstatuar gjatë ekzaminimit paraprak të situatës në tregun përkatës, Këshilli i Bashkësisë Drenas, është prezent në treg së bashku me ndërmarrjet tjera, të cilët në mënyrë të pavarur sigurojnë klientët për t'i ofruar shërbimet konkurruese siç janë: Transportin e Kufomave, Piramidat, Arkivolet, Qefini, Dërrasat, si dhe Hapja dhe Rregullimi i Varrit.

Autoriteti konsideron se, shërbime të cilat nuk janë konkurruese, të cilat i ofron vetëm Këshilli i Bashkësia Islame në Drenas, si organizatë e thirrur për zhvillimin e riteve fetare janë: Shërbimet e Morgut, Pastrimi dhe falja e namazit të xhenazës,. Kryerja e riteve fetare është e rregulluar me Kushtetutën e Bashkësisë Islame të Kosovës të vitin 2002, të cilat kryhen nga personat përgjegjës të deleguar nga Bashkësia Islame.

Sa i përket procedurave të prokurimit të negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës, zbatimin e këtyre procedurave e parasheh Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Në këtë rast, duke u bazuar në natyrën e punëve të këtij lloji të cilat mund të rrezikojnë reagim me urgjencë, në mënyrë që të mos mbetet zbrazët kjo pjesë, qytetarët e Drenasit do të përfitojnë nga kontrata për periudhën një vjeçare sipas nevojave të tyre. Pasi që zvarritja e kësaj procedure do të rezultonte në mungesë të shërbimeve, vonesa e të cilave do të mund të shkaktonte pengesa në kryerjen e shërbimeve të varrimeve, sipas legjislacionit të prokurimit publik. Është përgjegjësi e institucioneve, në këtë rast Komunës së Drenasit, të arsyetoj mjaftueshëm zhvillimin e procedurave të prokurimit të negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës.

Lidhur me ndalimin e pozitën dominuese ndaj Këshillit të Bashkësisë Islame në Drenas, bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 08/L-056, nuk është e kundërligjshme që një ndërmarrje të ketë pozitë dominuese, mirëpo nëse Autoriteti konstaton se ndërmarrja ka keqpërdor pozitën dominuese e bje ndesh me nenin 9 të LMK-së, si dhe Udhëzimin Administrativ nr. 08/2023 për Përcaktimin e Keqpërdorimit të Pozitës Dominuese, në këto raste Autoriteti ndërmerr veprime duke u bazuar në nenin 10 të LMK-së, me të cilin i ndalon ndërmarrjes të vazhdojë veprimin që shkelë konkurrencën, përcakton masat, kushtet dhe afatet për mënjanimin e efekteve të dëmshme të veprimeve që shkelin konkurrencën, si dhe shqipton gjohë në pajtim me ligjin.

Edhe pse është vërtetuar se BIK-u ka një pozitë dominuese në tregun e ofrimit të shërbimeve të varrimit për ritet fetare, d.m.th. një monopol ligjor, në kuptim të nenit 8 të LMK-se, gjendja faktike e vërtetuar nuk rezulton në ekzistimin e indikacioneve të mjaftueshme për fillimin e procedurës për konstatimin e keqpërdorimit të pozitës dominues ndaj BIK-ut në kuptim të nenit 37 të LMK-së dhe duke sipas nenin 9 të LMK-së, sa i përket pjesës së shërbimeve konkurruese.

Autoriteti pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, dokumentacionit të ofruar nga palët dhe takimeve të realizuara, erdhi në përfundim se nuk ka fakte dhe argumente mbi bazën e të cilave Autoriteti mund të fillojmë iniciimin e procedurës hetimore në lidhje me procedurën e negociuar të prokurimit në mes Komunës së Drenasit dhe Bashkësisë Islame në Drenas. Si rrjedhojë, as nuk mund të konstatohet ndonjë marrëveshje e ndaluar sipas LMK.

Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, vendosi si në diapozitiv të këtij Konkluzioni.

Obligohet Sekretariati që të kujdeset për zbatimin e këtij konkluzioni.

Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana Komisionit.

AUTORITETI I KONKURENCËS

Komisioni

Neime Binaku Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj
Anëtar

Floren Mehmeti
Anëtare

Salihe Gashi Loku
Anëtare

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative në afat prej 30 ditësh, nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.

Me këtë KONKLUZION të njoftohen:

- Paraqitësi i Iniciativës
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arkiva